



## Programi i Kualifikimit të Vijueshëm – 09, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 20 dhe 21 Dhjetor 2021

### E Enjte, 09 Dhjetor 2021 \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00		2 orë
Tema	<b><u>Ligji për pastrimin e parave</u></b>	
Pershkrimi	Cfarë parashikon ligji për audituesit ligjor; Baza ligjore për pastrimin e parave; Cilat janë raportimet, strukturat që duhet të krijojë audituesi ligjor;	

15.05		2 orë
Tema	<b><u>IFRS 9</u></b>	
Pershkrimi	Implikimi në strategjinë e auditimit ; Ky trajnim përfshin dhe Raste Praktike mbi IFRS 9 dhe strategjinë e auditimit.	

### E Premte, 10 Dhjetor 2021 \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00		2 orë
Tema	<b><u>Raportimet për qëllime të ligjittë pastrimit të parave nga pikëpamja e BMP-së</u></b>	
Pershkrimi	Përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës (DPPPP) nga subjektet e kësaj rregulloreje.	

15.05		2 orë
Tema	<b><u>Cfarë duhet të përmbajë rregullorja për pastrimin e parave</u></b>	
Pershkrimi	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të ndihmojë subjektet e rregullores “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, në administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	

### E Hënë, 13 Dhjetor 2021 \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00		2 orë
Tema	<b><u>Kërkesat për raportim sipas ligjit të ri të kontabilitetit</u></b>	
Pershkrimi	Cilat janë raportet shtesë që duhet të publikojnë njësi të ndryshme ekonomike: Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përcakton paarimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, përcaktimin e standardeve kontabël të zbatueshme, si dhe mbajtjen e kontabilitetit. Ky trajnim ka si bazë të saj qëllimin kryesor të ndryshimeve të këtij ligji që është përmirësimi i cilësisë së zbatueshmërisë së ligjit ekzistues, si dhe përditësimi i tij duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në vendin tonë, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.	

15.05		2 orë
Tema	<b><u>Formate të raporteve shtesë të kërkuara nga Ligji i Kontabilitetit</u></b>	
Pershkrimi	Udhëzues për Raportin e Performancës së Organizatave Jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri; Raporti i performancës ka si synim të sigurojë që në rastin e një organizate jofitimprurëse të jetë publikisht e përgjigjshme ndaj palëve të interesuar në paraqitjen e performancës së saj. OJF-të kanë një përgjegjësi shumë më të madhe ndaj një grupi më të gjerë të palëve të interesuara sesa, për shembull, njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.	



## Programi i Kualifikimit të Vijueshëm – 09, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 20 dhe 21 Dhjetor 2021

**E Martë, 14 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00	2 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Puna që duhet kryer nga audituesit ligjorë për informacionet e tjera dhe si adresohet në raportin e audituesit ligjorë</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	Cështje kryesore që korrespondon mbi këtë trajnim është: SNA 720 – Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera.

15.05	2 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Shembuj Praktikë</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	Raste të ndryshme të prezantuara lidhur me punën që duhet të kryhet nga audituesit ligjorë për informacionet e tjera dhe se si adresohet në raportin e audituesit ligjorë.

**E Mërkurë, 15 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00	3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Përdorimi i IT dhe ndërlidhja me procesin e fiskalizimit</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	<b><u>Si ndikon fiskalizimi në punën e audituesit:</u></b> Dispozitat e përgjithshme mbi fiskalizimin; Fazat e auditimit mbi bazë rreziku që ndahen në (faza paraprake, planifikimi dhe vlerësimi i rrezikut, përgjigja ndaj rreziqeve të vlerësuara, përfundimi dhe raportimi); Regjistrimet fillestare për qëllime të fiskalizimit; Faturat në procesin e fiskalizimit duke përfshirë rregullat e përgjishme, detyrimet për lëshimet e faturës dhe cilat janë përjashtimet nga detyrimi për lëshimin e faturës; Procesi i fiskalizimit; Deklarimet që lidhen me fiskalizimin; Problematika dhe konstatime mbi procesin e fiskalizimit.

**E Enjte, 16 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00	3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Përdorimi i IT dhe ndërlidhja me procesin e fiskalizimit</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	<b><u>Përfshirja e specialistëve të IT-së në auditimin e pasqyrave financiare:</u></b> Në këtë trajnim është shtjelluar gjerësisht Kontrolli i Përgjithshëm i sistemeve të Teknologjisë dhe Informacionit të cilat janë kontrole bazike ndaj sistemeve të IT-së për të siguruar që informacioni po përpunohet në një mjedis të sigurt dhe konsistent. Këto kontrole ruajnë dhe sigurojnë integritetin e të dhënave dhe proceseve të cilat përdor sistemi IT. Ky modul në mënyrë të strukturuar zhvillonë rendësinë e Kontrollit të Përgjithshëm IT në Auditimin e Pasqyrave Financiare.

16.00	2 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Raporti i Verifikimit të shpenzimeve – ISA përkatëse dhe modele raportimi</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	Fokusi i kwtij trajnimi ka qenw mbi përgjegjësitë e praktikantit kur angazhohet për të kryer një angazhim të procedurave të rëna dakord si dhe formën dhe përmbajtjen e raportit të procedurave për të cilat është rënë dakord.

**E Premte, 17 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

13.00	4 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Bashkëauditimet dhe si i trajtojnë SNA-të</u></b>
<b>Pershkrimi</b>	Hyrje në bashkë-auditim; Zhvillimi i bashkëauditimit në praktikë; Përmbledhje e benefiteve kryesore; Bashkë-auditimi, tenderimi i tij dhe rotacioni.

## Programi i Kualifikimit të Vijueshëm – 09, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 20 dhe 21 Dhjetor 2021

**E Hënë, 20 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

09.00		3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Parimi i Vijmësisë</u></b>	
<b>Pershkrimi</b>	<b>ISA 570 dhe Raste Praktike.</b> Objektivat e ISA 570 janë trajtuar në trajnim mbi objektivat kryesore të saj; Vlerësimi i rrezikut; Ngjarjet dhe kushtet; Cështje të entiteteve të vogla; Pasiguria material; Raportimi; Raste Studimore.	

09.00		3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Kuadri Rregullator i Bordit të Mbikëqyrjes Publike</u></b>	
<b>Pershkrimi</b>	<b>Ligji i Auditimit</b> Ky trajnim ka për bazë shtjellimin e Kuadrit Rregullator të BMP-së, qëllimin dhe objektin e saj të cilat përcaktojnë mënyrën e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale; Përcakton mënyrën e mbikëqyrjes së procesit të testimit dhe vlerësimit të kandidatëve për AL dhe KM; Parashikon rregullat & kriteret e përgjithshme mbi bazën e të cilave përgatiten të gjitha aktet, rregullat dhe vendimet që dalin në zbatim të kësaj rregulloreje; Parashikon rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen dhe rregullimin e procesit të testimit dhe certifikimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar. Përsa i përket Ligjit të Auditimit është specifikuar qëllimi dhe objekti ku ky ligj si qëllim ka përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të audituesit ligjor, si dhe rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar. Parashikon dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, të shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit.	

**E Martë, 21 Dhjetor 2021** \_me anë të platformës ZOOM Webinar

09.00		3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Parimi i Vijmësisë</u></b>	
<b>Pershkrimi</b>	<b>Ndikimi i pandemisë së Covid 19 dhe si adresohet në raportin e audituesit ligjor.</b> Në këtë trajnim fokus ka qenë Ndikimi i Covid-19 në Biznes; Ndikimi i Covid-19 në Auditim; Ndikimi i Covid-19 në Raportim.	

09.00		3 orë
<b>Tema</b>	<b><u>Kuadri Ligjor që prek cështjet e hyrjes dhe vijimit të ushtrimit të profesionit</u></b>	
<b>Pershkrimi</b>	Ky trajnim ka si bazë Ligjin për Auditimin ku në krerë të vecantë janë të specifikuar Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë dhe e Shoqëria Audituese e cila përfshin Përgatitjen e audituesve ligjorë; Audituesi Ligjor dhe Shoqëria Audituese e cila përfshin Përgatitjen e audituesve ligjorë; Nene të vecanta të Ligjit për Auditimin trajtojnë “Praktika profesionale dhe hyrja në profesion ; Kushtet e pranimit të kandidatëve në praktikën profesionale “; Për sa i përket testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjor është në seksion me vete në ligj që përfshin nenin për “Komisionin e Provimeve të Aftësive Profesionale; Provimin e aftësive Profesionale”.	

